



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, Ligjin nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. nenet 16 dhe 61 parag.1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, nxjerr këtë:

U R D H Ë R E S Ë

I

Urdhërohen Drejtorët e Drejtorive, si dhe përgjegjësit e njësive dhe institucioneve vartëse në kuadër të Komunës së Podujevës të angazhohen maksimalisht në respektimin e dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me theks sa i përket procedurave të publikimit dhe shpalljeve të dokumenteve dhe akteve të ndryshme komunale që ndërlidhen me të dhënat personale të individëve dhe subjekteve tjera të përcaktuara sipas Ligjit në fjalë.

II

Për të gjitha rastet e përpunimit të të dhënave personale nga ana e zyrtarëve përkatës, paraprakisht duhet të komunikohet me zyrtarin komunal të caktuar për mbrojtjen e të dhënave personale, nga i cili do të merren instruksionet dhe konfirmimet lidhur me përpunimin e të dhënave.

III

Gjithashtu në rast se aktualisht ka publikime të të dhënave personale që bien ndesh me dispozitat ligjore në fuqi, brenda afatit sa më të shkurtër të tërhiqen dhe të njëjtat të përpunohen në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale në fuqi.

IV

Urdhëresa hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:

Drejtorëve të Drejtorive

Përgjegjësve të njësive dhe institucioneve vartëse të Komunës

Zyrtarit të caktuar për mbrojtjen e të dhënave personale

Për njoftim; zyrtarëve përmes Drejtorëve të Drejtorive përkatëse

Arkivit

Nr. 02-016/01-0021874/22
Podujevë, 24 mars 2022

Kryetari i Komunës
Shpejtim Balliqi

